



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 25 shkurt 2016

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të nenit 17 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; si dhe në mbështetje të Rregullores për stazhin e praktikantëve në Gjykatën Kushtetuese, Nr. 04/12; me qëllim të edukimit profesional në fushën juridike të gjyimit dhe të interpretimit kushtetues, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpall publikisht

SHPREHJEN E INTERESIT për angazhimin e praktikantëve

1.

Pozita: Praktikant
Numri i pozitave: 8 (tetë)
Kohëzgjatja e punës: 3 (tre) muaj

Detyrat kryesore

Praktikanti kryen punë në Gjykatë sipas kushteve të parapara me Rregulloren për stazhin e praktikantit në Gjykatën Kushtetuese, Nr. 04/12.

Kualifikimet dhe aftësitë

- Kandidatët për praktikantë duhet të jenë juristë të kualifikuar, me diplomë universitare dhe/ose studentë në vitin përfundimtar të studimeve juridike;
- Kandidatët duhet ta njohin shkëlqyeshëm gjuhën angleze, si dhe të demonstrojnë shkathtësi solide kompjuterike.

Informata të përgjithshme për kandidatët

Përcaktimi i kompensimit për praktikantë bëhet në përputhje me vendimin e posaçëm të Gjykatës Kushtetuese.

Praktikanti, pas kalimit të afatit kohor për të cilin është pranuar në Gjykatë, i nënshtrohet vlerësimit të njohurive të fituara gjatë punës praktike.

Pas vlerësimit pozitiv nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, praktikanti pajiset me certifikatë me të cilën dëshmohet kryerja e suksesshme e punës praktike në Gjykatë.

Gjykata ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e praktikantëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të dërgohet nëpërmjet e-mailit, në adresën: lulzim.syla@rks-gov.net

Data e fundit e dorëzimit të aplikacioneve nga kandidatët e interesuar është më **11 mars 2016, në orën 16:00.**

Shënim:

Kërkesat e dërguara pas afatit të përcaktuar për dorëzimin e aplikacioneve, nuk do të pranohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.